



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 14, datë 28.09.2022

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:
“RIKONSTRUKSIONI I GODINAVE TË MATERNITETIT “MBRETËRESHA
GERALDINË” DHE NDËRTIM I RI 3 KAT”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Spitalit Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Rikonstruksioni i godinave të maternitetit “Mbretëresha Geraldinë” dhe ndërtim i ri 3 kat”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 11, datë 03.12.2020, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

OGERTA MANASTIRLIU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

